

TRANSFORMIMI I

GJELBËR

RAPORT MONITORIMI
Tetor-Dhjetor 2022



AUTOR
ORJANA ÇEKREZI

QENDRESA
QYTETARE



NED

NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al

Tabela e përmbajtjes:

Rëndësia e transformimit të gjelbër.....	3
Çfarë parashikon Agjenda e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor?	4
Nevoja për të diversifikuar burimet e energjisë si pjesë e Agjendës së Gjelbër	6
Një hap pas - kthimi tek energjitë e rinovueshme	7
Potenciali në zhvillim i diversifikimit të energjisë së rinovueshme	8
Gjetjet kryesore	10
Rekomandime.....	11
Bibliografia	12

**TRANSFORMIMI I
GJELBËR**

Rëndësia e transformimit të gjelbër

Transformimi i gjelbër, i njohur gjithashtu si tranzicioni drejt një ekonomie më të qëndrueshme dhe miqësore me mjedisin, po bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm në botën e sotme.

Transformimi i gjelbër është kritik në zbutjen e ndikimeve negative të ndryshimeve klimatike. Djegia e lëndëve djegëse fosile, shpyllëzimi dhe praktika të tjera të paqëndrueshme kanë çuar në emetimin e sasive të mëdha të gazeve serrë, si dioksidi i karbonit dhe metani, të cilët bllokojnë nxehtësinë në atmosferë dhe çojnë në ngrohjen globale. Pasojat e ngrohjes globale përfshijnë rritjen e nivelit të detit, ngjarjet më të shpeshta dhe të rënda të motit dhe çekuilibrat ekologjike.

Kjo përfshin kalimin në praktika të qëndrueshme që reduktojnë gjurmën tonë të karbonit dhe ulin varësinë tonë nga karburantet fosile. **Ky tranzicion përfshin adoptimin e burimeve të rinovueshme të energjisë si energjia diellore, era dhe hidrocentralet, si dhe masat për efikasitetin e energjisë si projektimi i ndërtesave të gjelbërta dhe sistemet efikase të transportit.** Duke reduktuar emetimet e gazeve serrë, transformimi i gjelbër ndihmon në zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe ndikimet e tij.

Sakaq miratimi i burimeve të rinovueshme të energjisë ka përfitimin shtesë të reduktimit të varësisë sonë nga lëndët djegëse fosile, të cilat mund të jenë të paqëndrueshme për sa i përket çmimit dhe disponueshmërisë. Duke investuar në burimet e rinovueshme të energjisë, vendet mund të sigurojnë një furnizim të qëndrueshëm dhe të parashikueshëm të energjisë, duke reduktuar potencialin për mungesa të energjisë dhe rritje të çmimeve.

Përveç motiveve të lartpërmendura mund të ketë edhe ndikime të tjera pozitive në mjedis, si ulja e ndotjes së ajrit dhe ujit, ruajtja e biodiversitetit dhe mbrojtja e burimeve natyrore.

Në përgjithësi, transformimi i gjelbër është i rëndësishëm për adresimin e disa prej sfidave më të mëdha me të cilat përballet bota sot, duke përfshirë ndryshimin e klimës, qëndrueshmërinë mjedisore, zhvillimin ekonomik dhe shëndetin publik dhe kërkon një ndryshim në të menduar dhe një përkushtim ndaj praktikave afatgjata dhe të qëndrueshme.

Për këto arsye shumë shtete në botë kanë ndërmarrë iniciativa të ndryshme duke synuar transformimin e gjelbër, ku një ndër to është dhe Agjenda e Gjelbër e krijuar dhe miratuar nga Bashkimi Europian.

Çfarë parashikon Agjenda e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor?

Marrëveshja e Gjelbër Europiane, e miratuar në vitin 2020, është një grup iniciativash politikash nga Komisioni Evropian me qëllimin kryesor për ta bërë BE neutral ndaj klimës në vitin 2050. Strategjia e Komisionit Evropian për ndryshimet klimatike, e nisur në vitin 2020, përqendrohet në një premtim për ta bërë Evropën një emetues neto zero të gazeve serrë deri në vitin 2050 dhe për të demonstruar se ekonomitë do të zhvillohen pa rritur përdorimin e burimeve. Megjithatë, Marrëveshja e Gjelbër ka masa për të siguruar që kombet që tashmë janë të varura nga lëndët djegëse fosile të mos mbeten prapa në tranzicionin drejt energjisë së rinovueshme, kjo pasi tranzicioni i gjelbër konsiderohet si prioritet kryesor për Evropën.

Ballkani Perëndimor është një nga rajonet Europiane më të prekura nga ndikimi i ndryshimeve klimatike, prandaj për tu ndërmarrë iniciativa të përafërta në linjë me Agjendën e Gjelbër, BE krijoi Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor, e cila u miratua nga vendet e rajonit në Samitin në Sofje në vitin 2020 dhe më tej Plani i saj i Veprimt në Samitin e Brdo në vitin 2021.

Lidhur me shtyllën e parë, ku kjo agjendë e ka të fokusuar veprimtarinë: "Veprimet klimatike, duke përfshirë dekarbonizimin, energjinë dhe lëvizshmërinë", aktualisht në rajon burimet e rinovueshme të energjisë, me dominimin e hidroenergjisë dhe bioenergjisë, përbëjnë një përqindje të rëndësishme të përzierjes së energjisë elektrike në disa ekonomi të rajonit. Agjenda parashikon se është e rëndësishme që këto burime të diversifikohen duke konsideruar më tepër energjinë diellore dhe potencialin e energjisë së erës. Sipas saj hapja e teknologjive moderne duhet të jenë shoqëruar me një më të mirë mjedisi investues.

Qeveritë e Ballkanit Perëndimor janë zotuar të ndjekin një tranzicion të energjisë së pastër dhe zhvillim të qëndrueshëm në Takimin Ministror në Podgoricë në shkurt 2019. Ky tranzicion duhet të reduktojë importet e energjisë, të zhvillojë burimet e rinovueshme të energjisë, të forcojë sigurinë energjetike rajonale, zhbllokojnë rritje më të madhe ekonomike dhe adresojnë ajrin e vazhdueshëm dhe sfidat e lidhura me ndotjen shëndetësore.

BE-ja do të mbështesë përafrimin e rajonit tonë me ambicien për ta bërë Evropën një kontinent neutral ndaj karbonit deri në vitin 2050.

Sipas Planit Ekonomik dhe Intensiv (2021-2027) lidhur me mbështetjen në energjitë e rinovueshme, BE nëpërmjet granteve të akorduara për Ballkanin Perëndimor, do të mbështesë Shqipërinë specifikisht në rehabilitimin e Hidrocentralit të Fierzës në Shqipëri deri në përfundim

të tij dhe avancimin në ndërtimin e Hidrocentralit të Skavicës, me qëllim rritjen e potencialit për vendin dhe në fund të rajonit me synimin për të rritur eksportin e energjisë elektrike nga energjia e pastër.

Ndërkohë në vitin 2022, që të adresojë pasojat e menjëhershme të krizës energjetike dhe të krijojë elasticitet në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme, për vitin 2023 dhe 2024, Ballkanit Perëndimor i është akorduar një buxhet prej 1 miliard euro nga BE, ku theksi i madh do t'i kushtohet integritet të tregut, dixhitalizimit të sistemit dhe rrjeteve inteligjente, eficiencës së energjisë, duke përfshirë modernizimin e ngrohjes qendrore, dhe sigurinë energjetike, ku një ndër projektet që përshin drejtpërsëdrejti edhe Shqipërinë është mbështetja e projektit për energji diellore mbi platformë lundruese në basenin e HEC të Vaut të Dejës me një kosto totale prej 12 milionë Euro.

Këto janë edhe drejtimet që përbëjnë një nga shtyllat kryesore të Planit të Investimeve për Ballkanin Perëndimor në linjë me synimet e Agjendës së Gjelbër.

Si nënshkruese e kësaj agjende, Shqipëria ka vendosur disa objektiva për t'iu përafuar atyre të agjendës, duke nisur që nga që politikat e energjisë, me qëllim përafrimin e legjislacionit të sektorit të energjisë me acquis-in e BE-së deri tek përcaktimi i objektivave strategjike për të krijuar përgjegjësi të qarta dhe transparente për zbatimin e tyre, të cilat konsiderohen prioritet në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim European 2030.

Objektivat strategjike të Planit Kombëtar të Veprimit për Klimën dhe Energjinë përfshijnë Strategjinë Kombëtare të Energjisë (SKE) dhe Kontributin Kombëtar të Pikësnyuar (KKP), ku SKE ka vendosur një objektiv prej 42% në TPES për BRE-të në 2030 dhe 15% reduktim të përdorimit të energjisë përmes masave për EE.

Strategjia Kombëtare e Energjisë (SKE) parashikon gjithashtu targetet të tjera për vitin 2030 sikurse: rritjen e kontributit të burimeve primare të energjisë kundrejt furnizimit total me burime primare të energjisë në nivelin 52.5% në vitin 2030, kursimi i të energjisë kundrejt konsumit total me 15% në vitin 2030, energjitë e rinovueshme kundrejt konsumit total të arrijnë në nivelin 42% në vitin 2030, reduktim i emetimeve GHG kundrejt totalit të arrijë 11.5% në vitin 2030, penetrimi i gazit natyror kundrejt furnizimit total me burime primare të energjisë të arrijë në nivelin 20% në vitin 2030, etj.

Ndërsa Kontributi Kombëtar i Pikësnyuar i rishikuar për Shqipërinë, përcakton se vendi ynë është angazhuar për një objektiv të reduktimit të pakushtëzuar të emetimeve prej 20.9% deri në vitin 2030 (sipas Marrëveshjes së Parisit) krahasuar me biznesin si zakonisht. Kjo është një rritje në krahasim me KKP-në e parë që synonte të

reduktonte emetimet me 11.5% deri në vitin 2030 krahasuar me nivelet e vitit 2016.

Konsumi i gazit natyror parashikohet të reduktohet me 79% midis skenarëve BaU dhe KKP për shkak të reduktimit të prodhimit të energjisë elektrike nga prodhimi i energjisë termike si pasojë e rritjes së prodhimit të energjisë së rinovueshme dhe reduktimit të humbjeve në shpërndarje dhe të konsumit final falë masave të efikasitetit të energjisë.

Sipas Komisionit Europian lidhur me Agjendën e Gjelbër, në disa nga gjetjet kyce të Raportit 2022 për Shqipërinë, rezulton se vendi ynë është mesatarisht e përgatitur për energjinë, mjedisin dhe ndryshimet klimatike. Theksohet se është bërë përparim i kufizuar në përafrimin e mëtejshëm me *acquis* të BE-së për menaxhimin e ujit, kimikatet dhe krimin mjedisor por ndikimi i investimeve strategjike në biodiversitet dhe mbrojtjen e natyrës kërkon vëmendje.

Nevoja për të diversifikuar burimet e energjisë si pjesë e Agjendës së Gjelbër

Në vitin 2021 Shqipëria u rendit nga Eurostat e treta në Europë pas Norvegjisë dhe Islandës për sasinë e lartë të prodhimit të energjisë elektrike për konsum nga burimet e rinovueshme në raport me totalin e konsumit. Gjatë këtyre viteve të fundit, politikat kombëtare të zhvillimit të Shqipërisë kanë synuar të ndryshojnë vendin në një superfuqi të prodhimit të energjisë.

Sipas të dhënave nga Ministria e Energjisë, nga viti 2005 deri në vitin 2022 janë nënshkruar në total 282 kontrata për ndërtimin e 621 HEC-eve, nga të cilat 25 kontrata për ndërtimin e 128 HEC-eve janë ndërprerë.

Në ditët e sotme ku ngrohja globale po impakton ndjeshëm ndryshimet klimatike, energjia e gjeneruar nga hidrocentralet, nuk është gjithnjë një alternativë premtuese, për shkak të ndryshimit të kushteve të motit por edhe të klimës në tërësi, prandaj edhe Agjenda e Gjelbër parashikon diversifikimin e burimeve të energjisë.

Krahas kësaj, hidrocentralet, edhe pse gjenerojnë energji nga një burim i rinovueshëm sikurse uji, nuk konsiderohen më një alternativë e gjelbër ose e qëndrueshme për shkak të shkak të ndikimeve shkatërruese afatgjata në mjedis, natyrë dhe komunitete. Ndihet gjerësisht se zhvillimi i pakontrolluar i HEC-ve sidomos atyre të vegjël, përbën një kërcënim ekzistencial për lumenjtë dhe përrenjtë shqiptarë.

Një ndikim tjetër tjetër i madh peshon në bimësinë dhe faunën e ekosistemeve ujore.

Sipas ekspertëve ka shumë HEC-e të vegjël janë ndërtuar në rrjedhat e lumenjve brenda zonave të mbrojtura ose në marrëdhënie ekologjike me to si psh në Valbonë, Lurë, Shebenik-Jablanicë, Hotovë-Dangëlli etj.

Gjithashtu numri i lartë i hidrocentraleve të vogla në të gjithë lumenjtë e vendit, nuk e mbulojnë nevojën kombëtare për energji, duke i bërë këto hidrocentrale përvecse të dëmshme pore dhe të padobishme.

Pasojat që vijnë nga ndërtimi i digave, tuneleve, rrugët e reja, kanaleve, përdorimi i lëndëve plasëse si dhe transmetimi, shkaktojnë probleme të tilla si erozioni, ndryshimi i biokoridoreve përgjatë përroit, ndikimi në cilësinë e ujit dhe tharja e shtratit që prek në mënyrë të drejtpërdrejtë komunitetin.

Për më tepër ndërtimi jo i mirëmenduar dhe masiv i hidrocentraleve në Shqipëri jo vetëm po than ujën e lumenjve, duke i lënë tokat bujqësore pa vaditje dhe duke ndikuar në biodiversitet si në rastin e hidrocentralit Madhesh por jo vetëm.

Një studim i kryer nga Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara, nxjerr në pah së deri në vitin 2018 janë ndërtuar 26 hidrocentrale në zona të mbrojtura si: Korab-Koritnik, Shebenikë-Jablanicë, Pellgu i Tomorrit, Rrjacë-Shebebnik, Pellgu i Lumit Seman etj.

Sakaq raporti i progresit të KE për Shqipërinë në Tetor 2022 thekson se progresi i kufizuar në reformën e tregut të energjisë elektrike dhe në sektorët e burimeve të rinovueshme dhe gazit dhe në linjat e interkonjeksionit rajonal kanë një ndikim direkt në përmbushjen e angazhimeve të Shqipërisë sipas Marrëveshjes së Parisit dhe nevojën për t'u angazhuar në tranzicionin e energjisë së pastër, në përputhje me Axhendën e Gjelbër për Ballkani Perëndimor.

Një hap pas - kthimi tek energjitë e parinovueshme

Në vitin 2021, Shqipëria i bashkohet **Aleancës ndërkombëtare për ndalimin e përdorimit të qymyrit**. Shqipëria është gjithashtu nënshkruese e Marrëveshjes së Parisit, një traktat ndërkombëtar mbi ndryshimin e klimës. Ajo synon të kufizojë ngrohjen globale në nën 2 ose 1.5 gradë Celcius krahasuar me nivelet para-industriale, nëpërmjet marrjes së masave me synim uljen e emetimeve të gazeve serë, dhe ndalimit të përdorimit të lëndëve djegëse fosile.

Mirëpo me nisjen e krizës energjetike në Europë, si pasojë e rritjes së çmimit të saj në tregjet ndërkombëtare, do të impaktohej edhe Shqipëria, duke marrë vendime që bien ndesh me ANNPQ. Kriza u

thellua edhe më tej nga agresioni rus në Ukrainë në shkurt të vitit të kaluar, në kushtet kur Europa 40% të nevojave për gaz i plotësonte nga Rusia.

Nisur nga kjo gjendje dhe nga mungesa e plotësimit të nevojave për energji në vend, Shqipëria merr vendime t'i rikthehet burimeve energjetike të parinovueshme si qymyri, nafta dhe gazi.

Për të parandaluar mungesën e energjisë elektrike, qeveria shqiptare ka konsideruar riaktivizimin e minierave, ku konkretisht pritet të riaktivizohet miniera në Kolonjë, sipas një leje të dhënë në nëntor 2022. Qeveria shqiptare ka marrë gjithashtu me qira dy termocentrale lundruese (anije), të cilat janë vendosur provizorisht në zonën e Petroliferës, në Gjirin e Vlorës, për t'u zhvendosur më pas në zonën e Triportit pranë termocentralit. TEC-et lundruese gjatë 2 viteve të para do të punojnë me naftë dhe pas dy vjetësh do të funksionojnë me gaz të lëngshëm dhe pritet të mbulojnë 15% të konsumit e energjisë në Shqipëri.

Aktivistë mjedisorë e civilë, si dhe media kanë shprehur shqetësime të ndryshme lidhur me termocentralet e Vlorës, duke qenë se efekti i aktivizimit të tyre do të ketë një impakt të jashtëzakonshëm në mjedis. Ndotja e ajrit dhe ujërave që do të rezultojë si pasojë e vënies në punë të këtyre termocentraleve, mund të sjellë shqetësime për biodiversitetin si dhe për jetën e njerëzve. Sipas ekspertëve termocentralet do të ndikojnë sidomos në mjedisin detar pasi qarkullimi i mijëra tonëve ujë të nxehtë në detë do të rrisë mbi 14 gradë temperaturat e ujërave detare duke 'rezikuar' gjallesat e detit.

Edhe përse Shqipëria ka rezerva të konsiderueshme të burimeve si qymyri, nafta e gazi, përsëri ato janë të kufizuara dhe gjenerimi i energjisë elektrike prej tyre mund të shkaktojë kosto të larta për mjedisin, prandaj duhet të konsiderohen dhe të invesohet në alternativat e gjelbërta dhe miqësore ndaj mjedisit.

Gjithashtu lidhur me Agjendën e Gjelbër, këto iniciativa nuk janë në linjë me objektivin e dekarbonizimit të sektorit të energjisë, por të ndërlydhura vetëm me diversifikimin e burimeve për gjenerimin e energjisë.

Potenciali në zhvillim i diversifikimit të energjisë së rinovueshme

Sipas Entit Rregullator të Energjisë, aktualisht Shqipëria prodhon 3% të energjisë elektrike nga panelet fotovoltaike. Disa nga projektet e tjera më të famshme fotovoltaike janë ato të liqenit të Banjës, parku fotovoltaike i Karavastasë, Spitalës, Fierit etj. Sërish edhe instalimi i

paneleve diellore mund të përbëjë risk ndaj mjedisit duke ndikuar në ekosistemet mjedisore, si psh ndërtimi në një zonë ku flora dhe fauna është shumë e pasur dhe cënon mbijetesën e shumë gjallesave.

Per herë të parë, në vitin 2022, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall thirrjen për aplikim të konsumatorëve familjarë për panele diellore me qëllim ngrihjen e ujit, me subvencionim në masën 70 % të koston nga Agjencia për Efiçencën e Energjisë. Kjo masë synon reduktimin e konsumit të energjisë elektrike dhe përmirësimi i furnizimit me ujë të ngrohtë sanitar dhe reduktimin e emetimeve të dioksidit të karbonit.

Sa i përket energjisë së erës, në vitin 2021, Ministria e Infrastrukturës dhe e Energjisë shpall ankandin e parë për shfrytëzimin e energjisë së erës si burim energjie.

Një vit më pas, në prill të vitit 2022, qeveria shqiptare për herë të parë miratoi ndërtimin e parkut të parë eolik në malet e Lezhës, nga i cili pritet të prodhohet rreth 1% të nevojave energjetike të vendit.

Një studim mbi përshtatshmërinë e zonave të mundshme për zhvillimin e projekteve të erës në Shqipëri, i komisionuar nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), përcakton në shkallë vendi 20% të tokës si të përshtatshme për shfrytëzim, një sipërfaqe që përkthehet në 325,000 hektarë, ndërsa përmban një hartë e cila përcakton shkallën e përshtatshmërisë nga 'E lartë' në 'E ulët', për të gjitha vendet ku zhvillimi i këtyre projekteve është i mundur. Studimi gjithashtu identifikon Zonat e Ndaluara të cilat nuk mund të shfrytëzohen, pavarësisht potencialit të tyre, siç janë zonat e mbrojtura.

Sakaq, Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë së Rinovueshme (IRENA), vlerëson se Shqipëria ka potencial diellor dhe eolik për prodhimin e më shumë se shtatë GË (gigavatë), që është tri herë më shumë se kapaciteti i përgjithshëm i prodhimit të energjisë në vend. Raporti i kësaj agjencie pretendon, se deri në vitin 2030, Shqipëria mund të prodhojë deri në 600 MË energji elektrike nga dielli dhe era.

Në tërësi, Shqipëria ka një pozicion të favorshëm gjeografik po ashtu ka dhe kushte klimatike shumë të favorshme për shfrytëzimin e energjisë diellore dhe asaj të erës. Intensiteti i lartë i rrezatimit diellor si dhe klima mesdhetare përcaktojnë një potencial energjetik më të madh se potenciali energjetik mesatar për shfrytëzimin e energjisë diellore.

Aktualisht iniciativat lidhur me gjenerimin e energjisë elektrike nga burimet si Dielli dhe era janë të pakta, por në rritje.

Përdorimi i energjisë së rinovueshme ka shumë përfitime të mëdha në mjedis, që përfshin zvogëlim të emetimeve të gazrave serë,

diversifikimin e furnizimeve të energjisë dhe një varësi të ulët nga tregjet e karburanteve fosile (në veçanti, nafta dhe gazi), të cilat janë në linjë edhe me përmbushjen e objektivave të Agjendës së Gjelbër.

Rritja e burimeve të ripërtëritshme të energjisë mund të stimulojë gjithashtu punësimin në Europë, përmes krijimit të vendeve të punës në teknologjitë e reja 'të gjelbra'.

Gjetjet kryesore

Marrëveshja e Gjelbër Europiane, e miratuar në vitin 2020, është një grup iniciativash politikash nga Komisioni European me qëllimin kryesor për ta bërë BE neutral ndaj klimës në vitin 2050.

Kontributi Kombëtar i Përcaktuar i rishikuar për Shqipërinë, përcakton se vendi ynë është angazhuar për një objektiv të reduktimit të pakushtëzuar të emetimeve prej 20.9% deri në vitin 2030 (sipas Marrëveshjes së Parisit) krahasuar me biznesin si zakonisht.

Varësia ndaj hidroenergjisë e ndihmon Shqipërinë për të dekarbonizuar sektorin e energjisë elektrike, por e bën të varur nga ndryshimet klimatike.

Zhvillimi i pakontrolluar i HEC-ve, sidomos atyre të vegjël, përbën një kërcënim ekzistencial për lumenjtë dhe përrenjtë shqiptarë, ndikon në florën dhe faunën e ekosistemeve ujore si dhe komunitetet.

Në vitin 2021, Shqipëria i bashkohet **Aleancës ndërkombëtare për ndalimin e përdorimit të qymyrit, ndërsa** në vitin 2022 vendi ynë, për shkak të krizës ekonomike, vendos ti kthehet burimeve të parinovueshme si qymyri, gazi dhe nafta.

Shqipëria ka bërë përparim në një sërë fushash që lidhen me sektorin e energjisë, duke përfshirë përmirësimin e efikasitetit të energjisë, promovimin e energjisë së rinovueshme dhe reformimin e sektorit të energjisë elektrike. Megjithatë, duhet bërë më shumë punë për të harmonizuar plotësisht standardet dhe rregulloret e BE-së dhe për të adresuar sfidat e rëndësishme me të cilat përballet sektori i energjisë në Shqipëri.

Rekomandime

- Shqipëria duhet të diversifikojë burimet e saja energjetike duke investuar më tepër në energjitë e tjera të rinovueshme përveç ujit, sikurse energjia e Diellit dhe e Erës, duke marrë parasysh kostot mjedisore.
- Diversifikimi i përdorimit të burimeve të energjisë në Shqipëri, duhet të jetë në linjë me objektivin e dekarbonizimit të sektorit të energjisë dhe jo kundër tij.
- Zhvillimi i teknologjive të reja mund të impaktojë në rritjen e efikasitetit të prodhimit të energjisë e gjithashtu dhe minimizimin e ndotjes. Me përdorimin e teknologjive të reja sidomos në ndërtim dhe në transport, ulja e konsumit të energjisë do të ndihmojë në mirëmenaxhimin e burimeve të saj si dhe do të kontribuojë në hapjen e vendeve të reja të punës në Europë.

**TRANSFORMIMI I
GJELBËR**

Bibliografia

1. Akademia e Studimeve Politike, 2022. Potenciali i Marrëveshjes së Gjelbër Europiane për Shqipërinë. Aksesuar në: https://www.asp.al/pdf/Potenciali_i_marreveshjes_se_gjelber_per_Shqiperine.pdf
2. Exit News, 2021. Katër vende të Ballkanit Perëndimor i bashkohen me Aleancën për Ndalimin e Përdorimit të Qymyrit. Aksesuar në: <https://exit.al/kater-vende-te-ballkanit-perendimor-bashkohen-me-aleancen-per-ndalimin-e-perdorimit-te-qymyrit/>
3. Monitor, 2023. Kriza e energjisë, riaktivizohet miniera e qymyrit në Kolonjë. Aksesuar nw: <https://www.monitor.al/kriza-e-energjise-riaktivizohet-miniera-e-qymyrit-ne-kolonjeo/>
4. Citizens Channel, 2023. “Të dëmshme dhe të padobishme”, rreth 1,100 hidrocentrale mbi lumenjtë e Shqipërisë dhe Bosnje Hercegovinës. Aksesuar nw: <https://citizens-channel.com/2023/01/31/te-demshme-dhe-te-padobishme-rreth-1100-hidrocentrale-mbi-lumenjte-e-shqiperise-dhe-bosnje-hercegovines/>
5. Reporter, 2021. “Shqetësimet mjedisore për termocentralet lundrues mbeten pa përgjigje.” Aksesuar nw: <https://www.reporter.al/2022/11/07/shqetesimet-mjedisore-mbi-termocentralet-lundrues-mbeten-pa-pergjigje/>
6. Monitor.al, 2021. Shqipëria, e treta në Europë për prodhimin e energjisë nga burimet e rinovueshme. Aksesuar në: <https://www.monitor.al/shqiperia-e-3-ta-ne-europe-per-prodhimin-e-energjise-nga-burimet-e-rinovueshme/>
7. Komisioni European. Shqipëria, e treta në Europë për prodhimin e energjisë nga burimet e rinovueshme. Aksesuar në: https://commission.europa.eu/strategy-and-policy/priorities-2019-2024/european-green-deal/energy-and-green-deal_en
8. Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri, 2022. Gjetjet kyçe të Raportit 2022 për Shqipërinë. Aksesuar ne: <https://www.eeas.europa.eu/delegations/albania/gjetjet-ky%C3%A7e-t%C3%AB-raportit-2022-p%C3%ABr-shqip%C3%ABrin%C3%AB-sq?s=214>
9. **Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, 2021.** Drafti i Planit Kombëtar i Republikës së Shqipërisë për Energjinë dhe Klimën. Aksesuar nw: https://www.infrastruktura.gov.al/wp-content/uploads/2021/11/NECP-Albania_drafti-shqip.pdf
10. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, 2021. KONTRIBUTI KOMBËTAR I PIKËSYNUAR (KKP) I RISHIKUAR PËR SHQIPËRINË. Aksesuar në:

<https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2021/10/3.-Kontributi-Komb%C3%ABtar-i-Percaktuar-KKP-i-rishikuar-p%C3%ABr-Shqip%C3%ABrin%C3%AB-1.pdf>

11. Gazetasi.al, 2021. Hapet ankandi për shfrytëzimin e erës si burim energjie. Aksesuar në: <https://gazetasi.al/balluku-hapet-ankandi-per-shfrytezimin-e-eres-si-burim-energjie/>
12. Faktoje.al, 2023. **Mbështetja e BE për Shqipërinë në kontekstin rajonal dhe pikat ku duhet ndryshuar. Aksesuar në:** <https://faktoje.al/mbeshtetja-e-be-per-shqiperine-ne-kontekstin-rajonal-dhe-pikat-ku-duhet-ndryshuar/>
13. European Commission, 2020. Questions and Answers: Economic and Investment Plan for the Western Balkans. https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/qanda_20_1819
14. Monitor.al, 2018. 149 HEC-et që po “minosin” zonat e mbrojtura. Aksesuar nw: <https://www.monitor.al/149-hec-et-qe-po-minosin-zonat-e-mbrojtura-2/>
15. Zëri i Amerikës, 2022. Termocentrali me gaz në Vlorë do të jetë i operueshëm në dhjetor 2023, thotë Balluku. Aksesuar në: <https://www.zeriamerikes.com/a/6557003.html>
16. Reporter.al, 2022. Shqetësimet mjedisore për termocentralet lundrues mbeten pa përgjigje. Aksesuar nw: <https://www.reporter.al/2022/11/07/shqetesimet-mjedisore-mbi-termocentralet-lundrues-mbeten-pa-pergjigje/>
17. AGJENCIA SHTETËRORE E PROGRAMIMIT STRATEGJIK DHE KORDINIMIT TË NDIHMËS ,2022. Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim European 2030. Aksesuar në: https://konsultimipublik.gov.al/documents/RENJK_538_Draft-Strategjia-Kombetare-per-Zhvillim-dhe-Integrim-2021--2030-.pdf
18. Regional Cooperation Council. GREEN AGENDA FOR THE WESTERN BALKANS. <https://www.rcc.int/greenagenda>
19. European Commission, 2020. Guidelines for the Implementation of the Green Agenda for the Western Balkans. https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2020-10/green_agenda_for_the_western_balkans_en.pdf

#QËNDRESË / MIRËQEVERISJE

QENDRESA
QYTETARE



NED

NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al